



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

PROJEKTVENDIM

NR____, DATË__/__/2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 468
DATË 23.12.2017 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
NË QYTETIN E DURRËSIT”, I NDRYSHUAR**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.9632, datë 30/10/2006 “ Për sistemin e taksave vendore ” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 datë 27/04/2017 “Për financat e e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, VKM nr. 226, datë 17.4.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, VKB nr. 569 datë 20.12.2018 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”, i ndryshuar dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare në Bashkinë Durrës, zëvendësryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës,

TË VENDOSË:

- Miratimin e ndryshimeve të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 468 datë 23.12.2017 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”, i ndryshuar, si më poshtë vijon:
- 1. Tabela nr. 3, Taksa mbi ndërtesat për kategorinë “Veprimtari tregti dhe shërbime” ndryshohet dhe formulohet si më poshtë :

Nr.	Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Niveli i Taksës mbi ndërtesat	
			A. Bashkia Durrës, Shkëmbi i Kavajes, Gjiri i Lalëzit,	B. Nj.A. Ishem, Katundi I RI, Manez, Sukth, Rrashbull
1	Ndërtesa Banimi	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$67.500 \times 0.05 \% \times m^2 = 33.75 \times m^2$	$67.500 \times 0.05 \% \times m^2 \times 65 \% = 21.9 \times m^2$
2	Veprimtari tregti dhe shërbime BM	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$67500 \times 1.5 \times 0.2 \% \times m^2 = 202.5 \times m^2$	$67500 \times 1.5 \times 0.2 \% \times m^2 = 202.5 \times m^2$
	Veprimtari tregti dhe shërbime BV	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$67500 \times 1.5 \times 0.2 \% \times m^2 = 202.5 \times m^2$	$67500 \times 1.5 \times 0.2 \% \times 0.7 \times m^2 = 141.75 \times m^2$
3	Parkim i mbuluar dhe bodrume	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$67500 \times 0.2 \% \times m^2 \times 70 \% = 94.5 \times m^2$	
4	Parkim i hapur	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$67500 \times 0.2 \% \times m^2 \times 30 \% = 40.5 \times m^2$	
5	Veprimtari industriale	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$67500 \times 0.2 \% \times m^2 \times 50 \% = 67.5 \times m^2$	
6	Ndërtesa që përdoren për bujqësi dhe blegtori	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$67500 \times 0.2 \% \times m^2 \times 30 \% = 40.5 \times m^2$	
7	Ndërtesat e privatizuara (për banim)	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$67500 \times 0.05 \% \times m^2 \times 70 \% = 23.6 \times m^2$	

2. Tek Përjashtimet nga taksa e ndërtesës, pikat **h** dhe **j** ndryshohen si më poshtë vijon:

- h) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
- j) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse

3. Tek tabela nr. 8 “Taksa e tabelës”, pika IV, Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola ndryshohet si më poshtë vijon:

IV	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura,panaire,spektakle, stenda reklamuese, banderola etj		
	Të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë /m ² /ditë	1 000

4. Në pikën A.3 “Tarifa të tjera” A.3.1 ”Tarifa të institucioneve të vartësisë”, pas tabelës 33,34 të shtohet paragrafi:

Lehtësirat që përfitojnë studentët e paisur me kartën studenti për frekuentimin e institucioneve socialkulturore.

- Frekuentimi i Bibliotekës Publike të qytetit pa pagesë.
- Biletat për aktivitete kulturore që do të organizohen në Qendrën Kulturore “Aleksandër Moisiu” për çdo ditë të javës do të jetë 100 Lekë, ndërsa në fundjavë do të jetë 200 lekë.
- Vizita në rrjetin muzeal do të jetë pa pagesë
- Bileta për frekuentimin e ambjentit të pishinës që ndodhet në Lagjen nr.1 të qytetit tonë do të jetë 100 Lekë/90 minuta.
- Biletat e aktiviteteve sportive (takime sportive dhe kampionate) që do të organizohen në Pallatin e Sportit “Ramazan Njala” do të jenë pa pagesë.
- Biletat e aktiviteteve sportive në stadiumin “Niko Dovana” (ndeshjet e futbollit), do të jetë 100 Lekë/bileta.

5. Pas tabelës 36, paragrafi Përjashtimet, ndryshohet dhe formulohet si më poshtë vijon:

1. Familjet të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike të përjashtohen nga detyrimi mujor.
2. Familjet me binjakë e lart paguajnë vetëm për njërin fëmijë.
3. Familje të cilët kanë një prind invalid (me komision mjeko ligjor) dhe tjetrin të papunë (vërtetim nga zyra punës) përfitojnë 50% reduktim nga detyrimi mujor.
4. Fëmijë të vajzave nëna, sipas statusit në regjistrat e Gjëndjes Civile përfitojnë gjithashtu 50% reduktim nga detyrimi mujor.
5. Familjet ku vetë fëmija që ndjek institucionet arsimore parashkollore është me aftësi të kufizuar të vërtetuar me komision mjeko-ligjor, përfitojnë 50% reduktim nga detyrimi mujor.
6. Fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian përfitojnë 50% reduktim nga detyrimi mujor.

- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjithë Drejtoritë e Bashkisë Durrës si dhe Institucionet në varësi të saj.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Nr. _____ Prot.

Durrës, më ____/____/ 2020

Lënda : Relacion për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 468 datë 23.12.2017 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit” të ndryshuar

KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

Të nderuar këshilltarë !

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria Arsim Kulturës nëpërmjet këtij relacioni paraqesin disa ndryshime dhe korrigjime të gabimeve materiale në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 468 datë 23.12.2017 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit” të ndryshuar me VKB nr. 522 datë 10.07.2018 dhe VKB nr. 569 datë 20.12.2018. Këto korrigjime vijnë si pasojë të gabimit njerëzor/gabimit material dhe rregullimet që do ju propozojmë janë në mbështetje të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore ” si edhe Vendimit nr. 132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.

Korrigjimet janë si më poshtë vijon :

- Në tabelën nr. 3 Taksa mbi ndërtesat është bërë një lapsus duke kopjuar vlerën e e njëjtë për kategorinë “Veprimtari tregti dhe shërbime ” si për biznesin e madh ashtu edhe për biznesin e vogel. Ndaj do e korrigjojmë si më poshtë:

Ishte :

Nr.	Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Niveli i Taksës mbi ndërtesat	
			C. Bashkia Durrës, Shkëmbi i Kavajes, Gjiri i	D. Nj.A. Ishem, Katundi I RI, Manez, Sukth,

			Lalëzit,	Rrashbull
1	Ndërtesa Banimi	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	67.500 x 0.05 % x m² = 33.75 x m²	67.500 x 0.05 % x m² x 65 % = 21.9 x m²
2	Veprimtari tregti dhe shërbime BM	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	67500 x 1.5 x 0.2 % x m ² = 202.5 x m ²	67500 x 1.5 x 0.2 % x m ² = 202.5 x m ²
	Veprimtari tregti dhe shërbime BV	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	67500 x 1.5 x 0.2 % x m ² = 202.5 x m ²	67500 x 1.5 x 0.2 % x m ² = 202.5 x m ²
3	Parkim i mbuluar dhe bodrume	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	67500 x 0.2 % x m ² x 70 % = 94.5 x m ²	
4	Parkim i hapur	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	67500 x 0.2 % x m ² x 30 % = 40.5 x m ²	
5	Veprimtari industriale	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	67500 x 0.2 % x m ² x 50 % = 67.5 x m ²	
6	Ndërtesa që përdoren për bujqësi dhe blegtori	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	67500 x 0.2 % x m ² x 30 % = 40.5 x m ²	
7	Ndërtesat e privatizuara (për banim)	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	67500 x 0.05 % x m ² x 70 % = 23.6 x m ²	

Bëhet

Nr.	Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Niveli i Taksës mbi ndërtesat	
			E. Bashkia Durrës, Shkëmbi i Kavajes, Gjiri i Lalëzit,	F. Nj.A. Ishem, Katundi I RI, Manez, Sukth, Rrashbull
1	Ndërtesa Banimi	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	67.500 x 0.05 % x m² = 33.75 x m²	67.500 x 0.05 % x m² x 65 % = 21.9 x m²
2	Veprimtari tregti dhe shërbime BM	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	67500 x 1.5 x 0.2 % x m ² = 202.5 x m ²	67500 x 1.5 x 0.2 % x m ² = 202.5 x m ²

	Veprimtari tregti dhe shërbime BV	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$67500 \times 1.5 \times 0.2 \% \times m^2 = 202.5 \times m^2$	$67500 \times 1.5 \times 0.2 \% \times 0.7 \times m^2 = 141.75 \times m^2$
3	Parkim i mbuluar dhe bodrume	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$67500 \times 0.2 \% \times m^2 \times 70 \% = 94.5 \times m^2$	
4	Parkim i hapur	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$67500 \times 0.2 \% \times m^2 \times 30 \% = 40.5 \times m^2$	
5	Veprimtari industriale	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$67500 \times 0.2 \% \times m^2 \times 50 \% = 67.5 \times m^2$	
6	Ndërtesa që përdoren për bujqësi dhe blegtori	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$67500 \times 0.2 \% \times m^2 \times 30 \% = 40.5 \times m^2$	
7	Ndërtesat e privatizuara (për banim)	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$67500 \times 0.05 \% \times m^2 \times 70 \% = 23.6 \times m^2$	

7. Tek Përrjashtimet nga taksa e ndërtesës, parashikim i cili ndodhet pas tabelës 3 të VKB nr. 569 datë 20.12.2018 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”, i ndryshuar do bëhet ndryshimi i pikës *h* dhe *j* si më poshtë :

Ishte :

Përrjashtime: Përrjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- h) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përrfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përrbëhet vetëm nga pensionistët;*
- j) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përrkohshme ose të përrhershme, përr kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi përr monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë”*

Bëhet :

Përrjashtime: Përrjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- h) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përrfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përrbëhet vetëm nga pensionistët, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë përr punë;*
- j) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përrkohshme ose të përrhershme, përr kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi përr monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përrdoren vetëm përr qëllime jofitimprurëse*

3. Tek tabela nr. 8 “Taksa e tabelës” pika IV, është bërë lapsus kategoria “Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj. e cila në bazë të ligjit dhe zbatueshmërisë në punën tonë është në vlerën 1000 lekë/m²/ditë është bërë gabimisht 1000 lekë/m²/vit.

Ndryshimi si më poshtë :

Ishte :

Nr.	LLOJI I TABELAVE	Nj/Matëse	Niveli i taksës
I	Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara osë jo ,brenda territorit,ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)		
a	deri ne 2 m ²	lekë /m ² /vit	0
b	mbi 2 m ² deri 10 m ²		
	e thjeshtë pa ndricim	lekë /m ² /vit	15 000
	me ndricim të thjeshtë	lekë /m ² /vit	20 000
	elektronike	lekë /m ² /vit	35 000
c	mbi 10 m ² deri 20 m ²		
	e thjeshtë pa ndricim	lekë /m ² /vit	12 750
	me ndricim të thjeshtë	lekë /m ² /vit	17 000
	elektronike	lekë /m ² /vit	29 750
d	mbi 40 m ²		
	e thjeshtë pa ndricim	lekë /m ² /vit	6 000
	me ndricim të thjeshtë	lekë /m ² /vit	8 000
	elektronike	lekë /m ² /vit	14 000
II	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		
	Tabela identifikuese	lekë /m ² /vit	120
III	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m ²		
	thjeshtë pa ndricim	lekë /m ² /vit	22 500
	elektronike	lekë /m ² /vit	45 000
IV	<i>Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura,panaire,spektakle, stenda reklamuese, banderola etj</i>		
	<i>Të të gjitha llojeve dhe përmasave</i>	<i>lekë /m² /vit</i>	<i>1 000</i>

Bëhet :

Nr.	LLOJI I TABELAVE	Nj/Matëse	Niveli i taksës
I	Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara osë jo ,brenda territorit,ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)		
a	deri ne 2 m ²	lekë /m ² /vit	0
b	mbi 2 m ² deri 10 m ²		
	e thjeshtë pa ndricim	lekë /m ² /vit	15 000
	me ndricim të thjeshtë	lekë /m ² /vit	20 000

	elektronike	lekë /m ² /vit	35 000
c	mbi 10 m² deri 20 m²		
	e thjeshtë pa ndricim	lekë /m ² /vit	12 750
	me ndricim të thjeshtë	lekë /m ² /vit	17 000
	elektronike	lekë /m ² /vit	29 750
d	mbi 40 m²		
	e thjeshtë pa ndricim	lekë /m ² /vit	6 000
	me ndricim të thjeshtë	lekë /m ² /vit	8 000
	elektronike	lekë /m ² /vit	14 000
II	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		
	Tabela identifikuese	lekë /m ² /vit	120
III	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m²		
	thjeshtë pa ndricim	lekë /m ² /vit	22 500
	elektronike	lekë /m ² /vit	45 000
IV	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura,panaire,spektakle, stenda reklamuese, banderola etj		
	<i>Të të gjitha llojeve dhe përmasave</i>	<i>lekë /m² /ditë</i>	<i>1 000</i>

Ne zbatim të VKM nr.226 datë 17.04.2019 2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me cmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, Drejtoria e Arsim, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare bëri takime për diskutimin e përfitimeve të shërbimeve me çmime të reduktuara në Bashkinë e Durrësit, të studentëve të pajisur me Kartë Studenti. Në këto takime morën pjesë: Biblioteka e qytetit, Qendra Kulturore “Aleksandër Moisiu”, Rrjeti Muzeal, Klubi Shumësportesh “Teuta”, në varësi të të cilit janë Pishina dhe Pallati i Sportit “Ramazan Njala”, Klubi i Futbollit “Teuta”. Pas diskutimit të mundësive të përfitimit të këtyre shërbimeve në qytetin tonë nga studentët e të gjithë Shqipërisë që janë të pajisur me Kartë Studenti, u vendos që këto çmime do të jenë si më poshtë:

4. Në pikën A.3, “Tarifa të tjera” A.3.1, ”Tarifa të institucioneve të vartësisë”, pas tabelës 33,34 të shtohet paragrafi:

Lehtësirat që përfitojnë studentët e paisur me kartën studentit.

- Frekuentimi i Bibliotekës Publike të qytetit pa pagesë.
- Biletat për aktivitete kulturore që do të organizohen në Qendrën Kulturore “Aleksandër Moisiu” për çdo ditë të javës do të jetë 100 Lekë, ndërsa në fundjavë do të jetë 200 lekë.
- Vizita në rrjetin muzeal do të jetë pa pagesë
- Bileta për frekuentimin e ambjentit të pishinës që ndodhet në Lagjen nr.1 të qytetit tonë do të jetë 100 Lekë/90 minuta.
- Biletat e aktiviteteve sportive (takime sportive dhe kampionate) që do të organizohen në Pallatin e Sportit “Ramazan Njala” do të jenë pa pagesë.
- Biletat e aktiviteteve sportive në stadiumin “Niko Dovana” (ndeshjet e futbollit), do të jetë 100 Lekë/bileta.

Sipas pikës 4 të Vendimit nr. 226 të Këshillit të Ministrave, datë 17.04.2019, ashtu siç është përmendur edhe më sipër, efektet financiare nga reduktimi i ketyre çmimeve do të përballohen nga buxheti i Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, të cilat do të pasqyrohen edhe në ndryshimet e paketës fiskale të vitit 2020.

Nëpërmjet këtij relacioni kjo drejtori kërkon që në paragrafin A.3 “Tarifa të tjera” A.3.1 ”Tarifa të institucioneve të vartësisë”,poshtë tabelës 33,34 të vendosen lehtësirat e mësipërme nga të cilat duhet të përfitojnë studentët të paisur me kartë studenti.

Drejtoria Arsim Kulturës, ju bën me dije se detyrimi mujor, në institucionet e përkujdesjes, çerdhesi dhe në institucionet arsimore parashkollore, kopshte përbëhet nga tarifa fikse dhe tarifa për ushqimin, ku kjo e fundit përlllogaritet me nivelin ditor të tarifës dhe ditët e frekuentimit të fëmijës në çerdhe/kopshte gjatë 1 muaji.

Lloji tarifës	NëÇerdhe	Në Kopsht
Tarifë per ushqim	165 lekë/ dite/ fëmijë	170 lekë/ ditë/ fëmijë
Tarifë fikse	360 lekë/muaj/ fëmijë	360 lekë/ muaj/ fëmijë

Me VKB 569 të datës 22.12.2018 “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në qytetin e Durrësit” u bë miratimi i propozimeve për familjet të cilat përfitojnë reduktim të detyrimit mujor si më poshtë:

PERJASHTIME

- 1- Familjet me ndihme ekonomike paguajne 50% te vleres se llogaritur per femije
- 2- Familjet me bijake e lart paguajne vetem per njerin femije.
- 3- “Vajzat nena” paguajne 50% te vleresper femijet e tyre.
- 4- Familjet qe nje bashkeshort e kane invalid dhe tjetrin te papune paguajne 50% te vleres se llogaritur per femije.
- 5- “Familjet ku vetë fëmija që ndjek institucionet arsimore parashkollore është me aftësi të kufizuar të vërtetuar me komision mjeko-ligjor, përfitojnë 50% reduktim nga detyrimi mujor.

Nëpërmjet këtij relacioni kjo drejtori kërkon që paragrafi “Përjashtime” të vendosura poshtë tabelës 35&36 “Tarifat në kopshte dhe çerdhe” të pësojë ndryshime, të shtohet pika 6, si dhe të formulohet si mëposhtë vijon:

Sqarojmë se fondi për këta fëmijë do të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Durrës.

PERJASHTIME

1. Familjet të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike të përjashtohen nga detyrimi mujor.
2. Familjet me binjakë e lart paguajnë vetëm për njërin fëmijë.

3. Familje të cilët kanë një prind invalid (me komision mjeko ligjor) dhe tjetrin të papunë (vërtetim nga zyra punës) përfitojnë 50% reduktim nga detyrimi mujor.
4. Fëmijë të vajzave nëna, sipas statusit në regjistrat e Gjëndjes Civile përfitojnë gjithashtu 50% reduktim nga detyrimi mujor.
5. Familjet ku vetë fëmija që ndjek institucionet arsimore parashkollore është me aftësi të kufizuar të vërtetuar me komision mjeko-ligjor, përfitojnë 50% reduktim nga detyrimi mujor.
6. Fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian përfitojnë 50% reduktim nga detyrimi mujor.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, ju ftojmë të miratoni ndryshimet e sipërcituara.